



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 15 paragrafi 5 nënparagrafi 5.1, 5.2, 5.3, 5.4, dhe nenit 2 paragrafi 1 të Ligjit 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, Udhëzimit Administrative Nr.03/2021 Për Kërkesat Themelore për Shëndet dhe Siguri, Procedurat dhe Dokumentacionin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje të Kategorisë I dhe II, nenit 21, 22 dhe 44 dhe 46 të Ligjit Nr.05/L-03 dt.21.06.2016 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, si dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr.351/01–229695/19 dt.18.09.2019 të aplikuesve Hasim Dërmaku, Albane Smajli, Feti Gashi, Jahir Ahmeti, Brahim Buzuku, Habib Leci, Elhame Pllana, Hamzi Kurteshi, Alush Zariqi, Fadil Grajçevci, Hysen Hajdini dhe investitori “Pozhegu Brothers” sh.p.k, me seli në Prishtinë, rr. “Muharrem Fejza” Mati 1, bl.C11/A1.lok.4 në Prishtinë, për legalizimin e ndërtimit sipas gjendjes ekzistuese me etazhitet 2B+P+6 si dhe caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për vazhdimin e ndërtimit të katit shtatë, tetë, nëntë dhe penthaus në ndërtesën shumë banesore me afarizëm, në kuadër të bllokut urban “C11”, të tërësisë hapësinore “C” të Planit Rregullues “Mati 1” dhe Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 19.08.2022, merr këtë:

## V E N D I M

### PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE PËR PËRFUNDIM TË NDËRTIMIT

**I. I caktohen kushtet ndërtimore** aplikuesve Hasim Dërmaku, Albane Smajli, Feti Gashi, Jahir Ahmeti, Brahim Buzuku, Habib Leci, Elhame Pllana, Hamzi Kurteshi, Alush Zariqi, Fadil Grajçevci, Hysen Hajdini dhe investitori “Pozhegu Brothers” sh.p.k, me seli në Prishtinë, dhe me numër unik identifikues 811251032 me pronar Qemajl Pozhegu, sipas kërkesës 05 Nr. 351/01–229695/19 dt.18.09.2019, për legalizimin e ndërtimit sipas gjendjes ekzistuese, me etazhitet 2B+P+6 si dhe caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për vazhdimin e ndërtimit të katit shtatë, tetë, nëntë dhe penthaus në ndërtesën shumë banesore me afarizëm, në kuadër të bllokut urban “C11”, të tërësisë hapësinore “C” të Planit Rregullues “Mati 1” dhe Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr.1609-0 (e formuar si produkt i bashkimit dhe ndarjes së disa prej parcelave të trajtuara me zgjidhjen urbane të Lejes Urbanistike, Konkluzionit dhe Kushteve Ndërtimore) ZK Matičan, sipas projekt propozimit/Plani i situacionit-“zgjidhjes urbane” të prezantuar.

**II.** Lokacioni i parcelës për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet në kuadër të bllokut urban “C11” tërësia hapësinore “C” të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë, miratuar me Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Rregullues “Mati 1” të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr.35-642 dt.01.04.2010 dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit Rregullues “Mati 1” të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr.031-1678 dt.20.07.2011.Lokacioni përfshihet edhe në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës, 01 nr.035-181427 dt. 24.09.2013, ku sipas këtyre planeve urbane kjo zonë është e paraparë të jetë “Ndërtim i lartë”.

**III.Gjendja ekzistuese** e lokacionit/parcelës së lartcekur, sipas gjendjes, kadastrale, pronësore, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
  - nr.1609-0.....S=5579 m<sup>2</sup>..... Elhame Pllana, Albane Smajli, Hamzi Kurteshi, Alush Zariqi, Jahir Ahmeti, Brahim Buzuku, Feti Gashi, Hysen Hajdini, Habib Leci, Hasim Dërmaku, Fadil Grajçevci.....”arë e klasës 3”;
- E drejta pronësore-juridike e parcelës së lartcekur, është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale dhe evidencës kadastrale, dhe është tokë e ndërtuar, me kyçje në infrastrukturë teknike: rrugë, ujësjellës, kanalizim, elektrikë dhe telefoni;

- Në kuadër të parcelës kadastrale të lartcekur, bazuar në incizimin gjeodezik të prezantuar ekziston ndërtesa ekzistuese me etazhitet 2B+P+6 e cila është në procedurë për vazhdimin të ndërtimit si dhe janë të ndërtuara ndërtesat me shumë njësi, konkretisht objekti A1, A2, B11, B12 dhe C23;
- Terreni ka pjerrtësi, në drejtimin veri-jug;
- Qasja e parcelës kadastrale është përmes rrugës ekzistuese “Skënder Çeku”, përkatësisht përmes parcelës kadastrale nr.824-3 ZK Matičan, me gjendje faktike rrugë e shtruar me kubëza dhe sipas gjendjes kadastrale me shfrytëzim aktual “infrastrukturë-rrugë”;
- Në hapësirën e përfshirë në diametër prej 50 m` ka ndërtesa ekzistuese, kryesisht ndërtesa shumëbanesore dhe ndërtesa individuale të banimit;

**IV. Kushtet ndërtimore** për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për rregullimin e hapësirës, sipas gjendjes së planifikuar, dhe realizimin ndërtimit të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, në parcelën ndërtimore në kuadër të pjesës së bllokut urban “C11”, të tërësisë hapësinore “C” të Planit Rregullues “Mati 1” dhe PZHU-së në Prishtinë, bazuar në parametrat, kriteret dhe rregullat urbane, të dokumenteve të planifikimit hapësinor-Planit Rregullues “Mati 1”, Lejes urbanistike 05 Nr.350-19832/1 dt.05.06.2012 dhe rregullativës ligjore në fuqi, janë:

- Organizimi dhe qasja në kompleks, pozicionimi, gabaritet, etazhiteti i ndërtesës, raporti i ndërtesës me vijën rregulluese dhe ndërtimore, si dhe me distanca nga kufiri i parcelës, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jetë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit-“zgjidhja urbane”, bashkëngjitur këtij vendimi për caktim të kushteve ndërtimore;
- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelës ndërtimore, në kuadër të pjesës së bllokut urban “C11”, të tërësisë hapësinore “C” të Planit Rregullues “Mati 1”, planifikohet të vazhdohet të ndërtohet ndërtesa shumë banesore me afarizëm, me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:

#### Ndërtesa shumë banesore me afarizëm

“Sipas incizimit gjeodezik gjendja ekzistuese/ realizuar “Ndërtesa me etazhitet 2B+P+6”

Ndërtesa Ekzistuese “Bodrumi -2” - S=483.65 m<sup>2</sup>

Ndërtesa Ekzistuese “Bodrumi -1” - S=483.65 m<sup>2</sup>

Ndërtesa Ekzistuese “Përdhesa” - S=340.01 m<sup>2</sup>

Ndërtesa Ekzistuese “Kati 1” - S=344.52 m<sup>2</sup>

Ndërtesa Ekzistuese “Kati 2” - S=344.58 m<sup>2</sup>

Ndërtesa Ekzistuese “Kati 3” - S=344.58 m<sup>2</sup>

Ndërtesa Ekzistuese “Kati 4” - S=344.58 m<sup>2</sup>

Ndërtesa Ekzistuese “Kati 5” - S=344.78 m<sup>2</sup>

Ndërtesa Ekzistuese “Kati 6” - S=344.78 m<sup>2</sup>

Sipërfaqja sipas gjendjes ekzistuese S=3,375.13 m<sup>2</sup>, S=2,407.83 m<sup>2</sup> mbi tokë+967.30m<sup>2</sup> nën tokë / të prezantuar me incizimi gjeodezik (lejuar me Ligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje Nr.06/L-024, neni 15 paragrafi 5.1 ” kushtet zhvillimore dhe ndërtimore nuk merren parasysh për vendndodhjen e ndërtimit pa leje të papërfunduar, shputën e ndërtimit pa leje të papërfunduar dhe lartësinë e ndërtimit pa leje të papërfunduar”).

Propozimi/planifikuar “Kati 7” - S=344.78 m<sup>2</sup>

Propozimi/planifikuar “Kati 8” - S=344.78 m<sup>2</sup>

Propozimi/planifikuar “Kati 9” - S=344.78 m<sup>2</sup>

Propozimi/planifikuar “Penthaus” - S=144.63 m<sup>2</sup>

Sipërfaqja e përgjithshme ekzistuese+ planifikuar për “Ndërtesa me etazhitet 2B+P+9+Penthaus”: S= 4,554.10 m<sup>2</sup> / 3,586.80 m<sup>2</sup> mbi tokë+967.30 m<sup>2</sup>, nën tokë/.

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore të kompleks (ISHP), brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesave në bazë / gabaritet të përdhësës ose suterrenit, lejohet max.40%, dhe kjo sipërfaqe është: dhe sipas projekt propozimit dhe e miratuar, kjo sipërfaqe është:
  - S=341.60 m<sup>2</sup> /lejuar sipas Lejes Urbanistike 05 Nr.350-19832/1 dt.05.06.2012 lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit i Komunës së Prishtinës/,
  - S=340,01m<sup>2</sup> sipas gjendjes ekzistuese të prezantuar me incizimi gjeodezik (lejuar me Ligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje Nr.06/L-024, neni 15 paragrafi 5.1 ” kushtet zhvillimore dhe ndërtimore nuk merren parasysh për vendndodhjen e ndërtimit pa leje të papërfunduar, shputën e ndërtimit pa leje të papërfunduar dhe lartësinë e ndërtimit pa leje të papërfunduar”).

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore të kompleks për nëntokë (ISHPN) për vendosjen e ndërtesave në bazë - gabarit të bodrumit, dhe bazuar në paragrafin II. pika 1. të Vendimit 01nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, lejohet max. 60%, kjo kalkulohet bazuar në parcelën ndërtimore dhe kjo sipërfaqe është:
  - $S=463.60 \text{ m}^2$  / lejuar sipas Lejes Urbanistike 05 Nr.350-19832/1 dt.05.06.2012 lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit i Komunës së Prishtinës /;
  - $S=483.65 \text{ m}^2$  sipas gjendjes ekzistuese- të prezantuar me incizimi gjeodezik lejuar me Ligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje Nr.06/L-024, neni 15 paragrafi 5.1 ”(kushtet zhvillimore dhe ndërtimore nuk merren parasysh për vendndodhjen e ndërtimit pa leje të papërfunduar, shputën e ndërtimit pa leje të papërfunduar dhe lartësinë e ndërtimit pa leje të papërfunduar”).
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për hapësira gjelbëruese (ISGJ), bazuar në paragrafin II. pika 2. të Vendimit 01 Nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është 0.4 (40%), dhe përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, 0.3 (30 %), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, dhe sipas grupeve-fazave të realizimit, kjo sipërfaqe është:
 

$S=5579 \times 0.4 = 2231.6 \text{ m}^2$  / lejuar sipas Vendimit të Kryetarit /;

~0.6 (60%) sipas gjendjes ekzistuese-të prezantuar me incizimi gjeodezik në kuadër të parcelës kadastrale nr.1609-0 (e formuar si produkt i bashkimit dhe ndarjes së disa prej parcelave të trajtuara me zgjidhjen urbane të Lejes Urbanistike, Konkluzionit dhe Kushteve Ndërtimore) ZK Matičan, ( këtu hyjnë jo vetëm sipërfaqet gjelbëruese por edhe sipërfaqet e shtigjeve të shtruara me kubëza që konsiderohen sipërfaqe absorbuese, apo të përshkueshme nga uji/ higroskopike.)
- Koeficienti i ndërtimit (ISHN) i parcelës ndërtimore bazuar në sipërfaqen e sajë sipas kriterëve të planeve urbane mund të jetë max.3.0. Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën  $\pm 0.00$ , **50%** për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - **suteren**, dhe **0%** për etazhet e nëntokës – **bodrum**, dhe kjo sipërfaqe është:
  - $S=3,586.80 \text{ m}^2$  mbi tokë /lejuar sipas Lejes Urbanistike 05 Nr.350-19832/1 dt.05.06.2012 lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit i Komunës së Prishtinës /;
  - $S=3,586.80 \text{ m}^2$  mbi tokë sipas projekt propozimit, vazhdimi i ndërtimit edhe për 3 etazhe duke llogaritur në koeficient sipërfaqen sipas matjeve gjeodezike;
- Bazuar në kriteret dhe parametrat e planit rregullues, “sipërfaqja e lirë përreth objektit duhet të pozicionohet në kuadër të ngastrës-parcelës kadastrale dhe për të siguruar dritë dhe ajër të mjaftueshëm, kjo sipërfaqe e lirë duhet të jetë prej  $0.4xh$  –lartësia e ndërtesës ose së paku  $3\text{m}$ ’, nga kufiri i parcelës. Ndërtimi lejohet vetëm duke respektuar vijën ndërtimore, në raste të veçanta kur nuk ka tejkalime nga parcela ndërtimore, lejohet tejkalimi i vijës së fasadës me ( ballkone, tenda të diellit) nese lartësia e lire mbi zonën e transportit publik eshte min.2.5m. Bazuar në kriteret e PZHU-së, distanca minimale në mes dy ndërtesave është  $1H$  (aty ku ka hapje të kthinave primare), kurse distanca minimale nga kufiri i parcelës kadastrale - parcelës ndërtimore, është  $0.75H$ , gjegjësisht  $0.5H$  me kushtin e mos tejkalimit të distancës në mes dy ndërtesave, prej  $1H$ . Te fasadat anësore, ku ka kthina sekondare, si: banjo, wc, depo, shkallë dhe garazhe, me marrëveshje të fqinjëve, kjo distancë mund të jetë 0. Të gjithë parametrat e sipërpërmendur të distancave janë respektuar për sipërfaqet/etazhat shtesë të projektuara (bazuar në projektin konceptual), përderisa ndërtimi ekzistues me etazhitet B+P+3 është në kundërshtim me distancat e përcaktuara/të lejuara me PZHU (lejuar me Ligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje Nr.06/L-024, neni 15 paragrafi 5.1 ” kushtet zhvillimore dhe ndërtimore nuk merren parasysh për vendndodhjen e ndërtimit pa leje të papërfunduar, shputën e ndërtimit pa leje të papërfunduar dhe lartësinë e ndërtimit pa leje të papërfunduar”):
  - Ana veri-perëndimore:  $0.60 \text{ m}$  ekzistuese (në etazhat ekzistuese-bodrumi -2 dhe -1 );  $6.50 \text{ m}$  (në etazhat ekzistuese -P+6);  $6.50 \text{ m}$  e propozuar (në etazhën shtatë, tetë, nëntë dhe penthaus) (nga kufiri i parces), ndërsa distanca objekt-objekt  $16.0 \text{ m}$  (objektet ekzistuese);
  - Ana jug-lindore:  $4.90 \text{ m}$  -ekzistuese (në të gjitha etazhat ekzistuese) nga rruga ekzistuese e bllokut;  $4.90 \text{ m}$  e propozuar (në etazhën shtatë, tetë nëntë dhe penthaus) nga rruga ekzistuese e bllokut ndërsa distanca objekt-objekt  $15.70 \text{ m}$  (objektet ekzistuese);
  - Ana veri-lindore: I bashkangjitet ndërtesës ekzistuese, konkretisht ndërtesës “C11/A/2” sipas Lejes Urbanistike dhe gjendjes faktike në teren;

- Ana jug-perëndimore veri-lindore: 4.90 m` nga kufiri i parcelës vija rregulluese sipas gjendjes ekzistuese (në të gjitha etazhat ekzistuese, brenda visë së ndërtimit sipas Prru “Mati1”)/ 4.90 m`në të njejtën vazhdimësi me etazhat ekzistuese brenda visë së ndërtimit sipas Prru “Mati1”) e propozuar/e lejuar;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, të jetë ndërtim shumë banesor dhe afarizëm, si dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo dhe hapësira garazhesh etj. (sipas projekt propozimit);
- Etazhiteti maksimal për bllokun urban “C11”, të tërësisë hapësinore “C” të Planit Rregullues “Mati 1”, është VII÷IX mbi tokë, sipas lejes Urbanistike është 2B+S+P+9, ndërsa etazhiteti i propozuar dhe i miratuar është -2B+P+9+Penthaus;
- Qasja në kompleks të jetë nga rrugët e planifikuara të planit rregullues urban, gjegjësisht nga rrugët ekzistuese, të cilat rrugë janë edhe rrugë e planifikuara, sikur në Plani i situacionit – “zgjidhja urbane” të prezantuar dhe miratuar; Qasja në parcelë të jetë kah rruga ekzistuese e lagjes, të cilat rrugë janë rrugë të planifikuara, sikur në Plani i situacionit- “zgjidhja urbane” e prezantuar;
- Parkimi i makinave për nevojat e pronarëve( shfrytëzuesve ) të ndërtesës kolektive të banimit të sigurohet në parcelën ndërtimore në brendi të bllokut. Për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi standardi i parkimit respektivisht i garazhimit sipa Planit Rregullues “Mati 1” Rregulloren e MMPH NR.03/2016 është 1 VP/njësi banimore.Për pjesën e afarizmit min.1 VP per 30M2 afarizem sipërfaqe e shfrytëzueshme. Garazhet e ndërtesave kolektive të banimit të vendosen në apo nën ndërtesa, në gabaritin e ndërtesës, apo nën tokë jashtë gabaritet të ndërtesës.
- Kompleksi të organizohet edhe me vend-parkimet e jashtme, rrugët, shtigjet, trotuaret, terrenet sportive , këndet e lodrave për femije etj.Në kuadër të parcelës të parashihen edhe vend-parkimet e jashtme, shtigjet, trotuaret, kënde të lojërave për fëmijë, etj.;
- Parcelat ndërtimore të ndërtesave shumëbanesore nuk duhet të rrethohen;
- Në kuadër të kompleksit të planifikohen hapësira-pika për grumbullimin dhe vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura-dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të eficientës së energjisë, dhe të përshtatet ambientit për rreth;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.
- Si dhe aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane dhe arkitektonike të përcaktuara në kriteret dhe parametrat urban të Planit Rregullues “Mati 1”.

**V. Kyçja në infrastrukturë** - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR “Prishtina” aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit, numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga “Termokos” - Ndrohitorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

**VI. Dokumentacioni ndërtimor/projekti kryesor**, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, “Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënim për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, “Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinore,

“Rregullore MMPH Nr. 03/2016 për normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi”, bazuar në “Udhëzim Administrativ Nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara”, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50 m<sup>2</sup>, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dymave dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiluarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro-energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizimi dhe masat e sigurisë në vendndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;
- Deklaratat nga projektuesit e fazave të nevojshme për hartimin e Projektit Kryesor, për nevojat e realizimit të ndërtimit, i cili do të jetë konform Kodit të Ndërtimit dhe rregulloreve teknike në fuqi.
- Raporti i stabilitetit të strukturës, i përgaditur nga inxhinjeri, që duhet të përfshijë përfundimin profesional për sigurinë dhe stabilitetin e ndërtimit ekzistues dhe ndikimit që mund të kenë sipërfaqet/etazhat shtesë të projektuara në stabilitetin e përgjithshëm të ndërtimit (Ky ndërtim duhet t'i plotësoj kushtet minimale të shëndetit dhe sigurisë për shfrytëzim). I njëjti raport mund të plotësohet edhe me shqyrtime, analiza, fotografi që inxhinjeri i konsideron të domosdoshme.
- Projektin për sanimin e pllakës së rrënuar.

**VII. Dokumentacioni ndërtimor** - Elaborati për Masat e mbrojtëse nga zjarri, hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e “Deklaratë” për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m<sup>2</sup>, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;

- Situacionin-"zgjdhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

**VIII. Marrëveshja për infrastrukturë** – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt.24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkë investim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuesit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit).

**IX. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore** - meqenëse parcela kadastrale nr.1609-0 ZK Matiçan, me sipërfaqe totale S=5579m<sup>2</sup> në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, për pjesën me sipërfaqe S=2581m<sup>2</sup> është e evidentuar me lloj të shfrytëzimit tokë bujqësore, me klasë të kualitetit “Arë e klasit 3”, kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do të ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Plani i situacionit – “zgjdhja urbane”, dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, sipërfaqen prej S~2581m<sup>2</sup>. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

